



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2024:284930

Datë: 20.11.2024

Numri i dokumentit: 06482994

P.nr.364/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, në përbërje prej gjyqtarës së vetme gjykuese Benita Berisha, me pjesëmarrjen e bashkëpunortit profesional Visar Zeqiri, në çështjen penale kundër të pandehurit F. S. nga Lipjani rruga "A. K.", të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.2523/24, të datës 02.10.2024, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë për dhënien e urdhrit ndëshkimor, jashtë seancës, me datën 20.11.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-së në Prishtinë, PP.II.nr.2523/24, të datës 02.10.2024, dhe kjo gjykatë konform dispozitës të nenit 495 të KPPK-së, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Kundër të pandehurit:

F. S., i lindur me datën *data e lindjes...*, në Prishtinë, tani me vendbanim në Lipjan rruga "A. K.", nga i ati A. dhe e ëma A., e gjinisë K., i gjendjes së mirë ekonomike, me profesion ekonomist, me numër personal-*numri...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE:

Me datën 16.12.2023, në Lipjan, në objektin banesor ku shfrytëzues i njehsorit me numër 3506405 është i pandehuri F. S. me qëllim të përfitimit të pasurisë në mënyrë të kundërligjshme, njehsori pllombat i ka të manipuluar të hapura dhe të mbyllura prape, me çka të dëmtuarës KEDS i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 488.53.-€,-

-Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, konform dispozitave të neneve, 1, 2, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70 si dhe nenit 314 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe neneve 364, 449, 452, 462, 493 dhe 495 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon me:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **300.-€**, (treqind euro), të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata

dënimin me gjobë do ta zëvendësojë me dënim me burgim, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€.

OBLIGOHET i pandehuri, që të dëmtuarës KEDS-Distrikti në Ferizaj, t'ia kompensoj shumën e dëmit të shkaktuar në vlerë prej 488.53.-€, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

OBLIGOHET i pandehuri që kësaj gjykate në emër të shpenzimeve të procedurës penale për paushallin gjyqësor ti paguaj shumën prej 20.00.-€, si dhe për Fondin e kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 20.00.-€, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj PP.II.nr.2523/24, të datës 02.10.2024, e ka akuzuar të pandehurin F. S., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe njëherit ka kërkuar që të pandehurit ti shqiptohet urdhër ndëshkimor për veprën e lartcekur penale.

Gjyqtarja e vetme gjykuese pasi shqyrtoi provat që janë bashkangjitur aktakuzës respektivisht kallëzimit penal me numër të rastit CMS-K/DFE-122, i datës 17.05.2024, fatura DFEHP 2424194 e dt.19.04.2024, Kalkulimi i RH i dt.15.04.2024, procesverbal i KEDS me nr.2034212, e dt.03.04.2024, procesverbali me nr.26/24, i dt.24.02.2024, procesverbali me nr.0223163, e dt.18.12.2023, deklarata e të pandehurit F. S. e dhënë në Polici e datës 17.09.2024, foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes dhe shkresave tjera të lëndës, konstaton se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës, në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me dispozitën e nenit 493 të KPPK-së parashihet se “Për vepra penale për të cilat parashihet dënim me gjobë ose burgim deri në tri (3) vjet, për të cilat prokurori i shtetit është informuar në bazë të provave të besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë në aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor, në të cilin të akuzuarit do ti shqiptojë dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor”.

Gjyqtarja me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes konform nenit 495 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor ndaj të pandehurit nga arsyet se dënimi për veprën penale me të cilën ngarkohet i akuzuari është dënim me gjobë ose me burgim deri në tri (3) vjet, andaj gjykata konform dispozitave të lartcekura vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u bazua konform nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 dhe nenit 452 par.1 të KPPK-së, ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të nenit 36 par. 3 nën par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore- juridike, u bazua konform nenit 462 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr. 364/24, me datën 20.11.2024.

Bashkëpuntori Profesional
Visar Zeqiri

G J Y Q T A R J A
Benita Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim, në afat prej 8 (tetë) ditëve, nga dita e pranimit të tij. Kundërshtimi i parashtrohet kësaj Gjykate.